



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 81-të të mbajtur më 03.02.2023 ka miratuar si në vijim.

Vendim

Procedura sipas lëndës 12-3385/1 të datës 01.07.2019 e formuar sipas denoncimit me të dhëna për dyshime për veprime korruptive të ish-funksionarëve - personave të zgjedhur dhe të emëruar, NDËRPRITET.

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktëve të Intereseve, nuk ka elemente për veprim të mëtejshëm për shkak se denoncimi është dorëzuar në procedurën e duhur të një autoriteti tjetër kompetent për të ndërmarrë veprime nga kompetenca e tij.

Denoncimi me numër 12-3385/1 datë 01.07.2019 të mbyllet dhe arkivohet.

Vendimi në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetërorë brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e miratimit.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur, -----, është dorëzuar denoncim me nr. 12-3385/1 i datës 01.07.2019, i cili është shkruar në gjuhën angleze, me dokumentacion të bashkëngjitur, pas të cilit është formuar lënda me të dhëna për dyshime për veprimet korruptive të ish-funksionarëve - persona të zgjedhur dhe të emëruar për të cilët parashtruesi i ndan me KSHPK-në njohuritë e tij për marrëdhëniet e tyre biznesi dhe kriminale me persona juridik nga Republika e Çekisë dhe për realizimin e përfitimit të paligjshëm të pasurisë me madhësi më të madhe.

Në lidhje me përmbajtjen e denoncimit në rastin në fjalë, u mbajt një takim këshillues me drejtorin e Drejtorisë së Inteligjencës Financiare, pas së cilës KSHPK-ja i dorëzoi anketën Drejtorisë së Inteligjencës Financiare për të vepruar në përputhje me kompetencat e saj ligjore, sipas deklaratave të parashtruesit dhe bazuar në dokumentimin e dorëzuar.

Në bazë të të dhënave të mësipërme, KSHPK-ja nuk ka elemente për veprime të mëtutjeshme në rastin e lëndës dhe vendosi si në dispozitën e këtij Vendimi.

**KOMISIONI SHETËTORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
kryetare**

Biljana Ivanovska

Dorëzuar: - parashtruesi i denoncimit
përgatiti: J.C.
Miratoi: Mr. V.G anëtar i KSHPK-së

